

**Përgatitja për sulmin ndaj Kishës Katolike**

Marrëdhënia e ideologjisë komuniste dhe e “socializmit të zbatuar” me Kishën Katolike është shenjuar nga një përplasje dramatike e kundërshti që në agun e “fantazmës komuniste”! Zgjon kureshtje fakti që Papa përmendet si armiku i parë i “fantazmës komuniste” në Manifestin e Partisë Komuniste dhe bash në fjalinë e dytë të këtij dokumenti:

*“Një fantazmë sillet nëpër Evropë – fantazma e komunizmit. Të gjitha forcat e Evropës plakë, papa dhe cari, Meternihu dhe Gizoi, radikalët francezë dhe policët gjermanë janë bashkuar për t’i bërë luftën e shenjtë kësaj fantazme.”<sup>1</sup>*

Prifti, si figurë qendrore e Kishës, vërehet si person që ka kaluar në punëtor me mëditje në shërbim të borgjezisë:

*“Borgjezia ua hoqi aureolën e shenjtë të gjitha llojeve të veprimtarisë, që deri në atë kohë gëzonin nder dhe respekt të thellë. Mjekun, juristin, priftin, poetin dhe shkencëtarin ajo i shndërroi në punëtorë të saj me mëditje.”<sup>2</sup>*

Akoma pa filluar zbatimin e ideologjisë marksiste në përvojat tragjike të Bashkimit Sovjetik, udhëheqësi shpirtëror i Kishës Katolike konsiderohej si armiku i parë në listën e armiqve të proletariatit. Krejt paqartësi dhe premisë për rrëmujë në arsyetim përcjell edhe një fragment të “Principet e Komunizmit” të F. Engelsit, në të cilin nuk i jepet përgjigje pyetjes në tekstin origjinal se si do të sillej komunizmi kundrejt fesë:

*“Pyetje: Çfarë qëndrimi do të mbani kundrejt feve ekzistuese?  
- Mbetet!”<sup>3</sup>*

Në Manifestin e Partisë Komuniste krishterimi shihet përherë si rrezik i mundshëm për të tradhtuar idealet e proletariatit. Kjo duket qartë edhe nga trajtimi i asketizmit kristian:

*“S’ka gjë më të lehtë se t’i japësh një ngjyrë socialiste asketizmit kristian.*

1 Marx – Engels. *Manifesto e Principi del Comunismo*. Bompiani. Milano, 2009, f. 229.

2 Po aty, f. 239.

3 Po aty, f. 368.

*A nuk ka luftuar edhe kristianizmi kundër pronës private, kundër martesës, kundër shtetit? Dhe në vend të këtyre, a nuk ka predikuar ai se duhet të jesh mirëbërës dhe lypës, se duhet të mos martoresh dhe të mortnosh trupin, se duhet të bësh jetën e murgjëve dhe të vesh në kishë? Socializmi kristian s'është gjë tjetër veçse uji i bekuar, me të cilin prifti spërkat mërinë e aristokratëve.”<sup>4</sup>*

Në Shqipëri e viteve të para pas 1944-s, përveçse në studimet filozofike në shkollat fetare e sidomos në Institutin Teologjik e Filozofik në Shkodër, nuk mund të flitej mirëfilli për studiues të filozofisë. Edhe ata meshtarë apo laikë që kishin studiuar filozofi në universitetet perëndimore shikoheshin me mjaft dyshim nga qeveria e re komuniste. Drejtuesit e rinj të Partisë Komuniste Shqiptare që morën pushtetin pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore ishin pak a shumë familjarë, ndonëse jo të thelluar, me qëndrimet e filozofisë marksiste ndaj fesë dhe e shikonin fenë, e veçanërisht atë katolike, si kërcënim ndaj pushtetit totalitar. Edhe përvoja e Bashkimit Sovjetik me Kishën i kishte vënë në alarm se Kisha duhet mbajtur nën mbikëqyrje si institucion që mund të rrezikojë pushtetin.

Ndërkohë, në realitetin e ri gjeopolitik të krijuar pas Luftës së Dytë Botërore, kur shumë vende ranë nën ndikimin sovjetik, qeveria e BS-së kërkonte të koordinonte një plan të përbashkët të kampit socialist për luftën ndaj Kishës Katolike:

*“Viti 1948 paraqet një pikë kthese në marrëdhëniet mes Kishës dhe shtetit në Europë: në atë vit filloi një përballje ideologjike mes Lindjes dhe Perëndimit, në gjendje për të provokuar tension në të gjithë botën. [...] Në Kongresin e partive komuniste në Szklarska Poręba në 1947, përfaqësuesi rus Ždanov Andriej Aleksandrovič (1896-1948) paraqiti një plan eliminimi të Kishës katolike në të gjitha vendet e bllokut sovjetik. Projekti i tij bazohej në modelin sovjetik të viteve '20 në Bashkimin Sovjetik dhe konsistonte në shkatërrimin e hierarkive e më pas të figurave më të shquara mes meshtarësh dhe laikësh. Në fazën e parë duhej të arrestoheshin ipeshkvijtë, duke eliminuar udhëheqjen e Kishës, dhe duheshin izoluar personat që vlerësoheshin nga besimtarët. Në të njëjtën kohë duheshin krijuar grupe të laikëve bashkëpunëtorë, besnikë të regjimit dhe kundërshtarë të hierarkisë”<sup>5</sup>.*

Por përpara se qeveria komuniste të binte në kontakt me këtë plan nëpërmjet përfaqësuesve të saj, qysh gjatë luftës nacional-çlirimtare E. Hoxha shprehet me armiqësi ndaj Kishës Katolike dhe klerit katolik. Është e rëndësishme të theksohet se kundërshtia e parë e diktatorit ndaj fesë

4 Po aty, f. 293.

5 Mikrut, J. *La Chiesa cattolica e il comunismo in Europa centro-orientale e in Unione Sovietica* (a cura di), pag. 15.

fillon me sulmin e tij simbolik ligjërues ndaj klerit katolik. Për herë të parë E. Hoxha përmend klerin katolik në një referat në shkurt të vitit 1943:

*“Ka zogistë, dhe me këta lipset të bëjmë politikë afrimi dhe bashkëpunimi. Është kleri katolik, i cili është i organizuar dhe përfaqëson një fuqi politike pak a shumë nën influencën e okupatorit. Puna jonë e do që ne t’i afrojmë, t’u zgjatim dorën dhe t’i bindim për bashkëpunim të gjithë ata elementë që e kanë kuptuar rolin e poshtër të okupatorit dhe janë të vendosur ta luftojnë.”<sup>6</sup>*

Me kalimin e kohës, ligjërimi i E. Hoxhës bëhet përherë e më i ashpër dhe më kërcënues. Në një hark kohor prej 6 muajsh, në shtator të vitit 1943, nga kushtet e një qëndrimi propozues kalohet drejt një pozicioni kërcënues:

*“Me klerin katolik të Shkodrës e të malësisë: të përpiqemi që ata të largohen nga rruga e luftës kundër lëvizjes nacionalçlirimtare, përndryshe t’i luftojmë pa mëshirë.”<sup>7</sup>*

Këto janë dy momentet më të rëndësishme gjatë luftës ku diktatori Hoxha cek problemin e marrëdhënive të Partisë Komuniste me Klerin Katolik, të cilin e shikon si kërcënues të pushtetit të tij. Është e mundur që, gjatë qëndrimit të tij në Francë, E. Hoxha, megjithëse i pashquar në studime, të ketë rënë në kontakt të përciptë me idetë komuniste dhe të ketë pasur një pluhurosje ideologjike marksiste të mjaftueshme për të kuptuar që Kisha Katolike shikohej si rrezik nga komunizmi.

Në fakt diktatori Hoxha kalon nga “fjalët te veprat” që të nesërmen e largimit të ushtrisë gjermane nga Shqipëria. Qëndrimi i ashpër ndaj Kishës duket haptazi në veprimtarinë e të gjitha strukturave shtetërore. Saktësisht një vit e tre muaj pas largimit të ushtrisë gjermane, më 4 mars 1946 vriten barbarisht Atë Gjon Fausti, Atë Daniel Dajani, Atë Gjon Shllaku, nxënësi Mark Çuni dhe dy laikët Qerim Sadiku dhe Gjelosh Lulashi. Kjo datë ishte preludi tragjik i asaj masakre që do të vazhdonte deri në rënien e regjimit komunist.

Në kontekstin shqiptar sulmi ndaj Kishës dhe klerit katolik ka qenë shumë më i dallueshëm përkundrejt sulmit që u është bërë feve të tjera. Madje, duke analizuar me vëmendje përmasat specifike të persekutimit dhe veprat e botuara të E. Hoxhës, mund të ngrihet hipoteza se nëse në

6 Hoxha, E. Vepra. Vëll. 1, f. 304. Direktivat e Internacionales Komuniste. *Referat i mbajtur në mbledhjen e KQ të PKSH*. Shkurt. 1943.

7 Hoxha, E. Vepra. Vëll. 1, f. 469. *Mbi qëndrimin kundrejt rrymave të ndryshme jashtë Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Referat në Konferencën e Dytë Nacionalçlirimtare të Labinotit*. 6 shtator 1943.

Shqipëri nuk do të kishte pasur prani të Kishës Katolike, ngjarjet e vitit 1967 mund të mos kishin ndodhur. Në çdo pjesë të veprës së E. Hoxhës, kudo ku flitet për fetë, kleri katolik paraqitet si armiku më i madh i popullit dhe hera-herës i vetmi. Në fragmentin e mëposhtëm ku përmenden të gjithë armiqtë e mundshëm të qeverisë, nga hapësirat fetare përmendet vetëm kleri katolik.

*“Situata ndërkombëtare dhe qëndrimi jo i favorshëm që mbajnë aleatët anglo-amerikanë kundrejt qeverisë dhe pushtetit tonë, po favorizojnë grumbullimin e elementëve reaksionarë si elementët e pakënaqur, klerin katolik, intelektualët e pasqaruar dhe që kanë qenë ose në pozitat e armikut ose indiferentë, shtresat e tregëtarëve të mëdhenj, që janë goditur nga tatimet e fitimeve të jashtzakonshme, spekulatorët e përhershëm, shtresat e bejlerëve dhe të agallarëve që janë prekur nga ligji i reformës agrare.”<sup>8</sup>*

Jo vetëm kaq, sepse edhe në përkufizimin që E. Hoxha u bën armiqve të popullit, nga hapësira fetare përfshin vetëm klerin katolik. Sipas tij, priftërinjtë katolikë *“janë pjesë e llumit dhe e mbeturinave të reaksionit”*. Askund në veprat e tij nuk gjejmë cilësime të tilla për klerikët e feve të tjera. Në çdo fragment ku diktatori përshkruan fetë, të keqen e barazon me Kishën Katolike.

*“Gjyqet e popullit kanë gjykuar armiqtë e popullit. Ç’ishin këta njerëz, ç’përfaqësonin këta njerëz dhe ç’ishin qëllimet e tyre? Këta kriminelë, që kanë marrë dënimin e merituar, kanë qenë feudalë, bajraktarë, **priftërinj katolikë**, tregëtarë të pasur, intelektualë aventurierë dhe të shitur, me njëqind flamurë në xhep, oficerë tradhëtarë të regjimit të Zogut, gjithë llumi dhe mbeturinat e fashizmit dhe të reaksionit të brendshëm.”<sup>9</sup> (nënvizimi i A.N.)!*

Në favor të kësaj hipoteze që përmendëm më lart shkon edhe paralelizmi i vazhdueshëm që haset te veprat e marra në analizë ndërmjet veprimtarisë armiqësore të klerit katolik dhe Vatikanit. Ndërkohë që për besimet e tjera fetare nuk shihet ndonjë lidhje me njësi të tjera fetare *“të rrezikshme”* jashtë Shqipërisë.

*“Kleri katolik është një ent i organizuar mirë, me tradita dhe me lidhje të ngushta me reaksionin e jashtëm e me Vatikanin. Prandaj organizimit të tij, duhet t’i kundërvëmë organizimin tonë më të shëndoshë, politikës së tij, vijën tonë politike të drejtë dhe ta detyrojmë të luftojë në terrenin tonë dhe jo në terrenin e tij dhe me parullat që do ai. Lufta dhe politika me individë*

8 Hoxha, E. Vepra. Vëll. 3, f. 139.

9 Hoxha, E. Vepra. Vëll. 3, f. 462.

*të shkëputur të klerit është e nevojshme. Ka pasë momente që kleri katolik, ka qenë në luftë të hapët me ne duke na luftuar edhe me armë. Ne i jemi përgjegjur dhe e kemi goditur.”<sup>10</sup>*

E. Hoxha në një intervistë të datës 26 janar 1946 paraqet, sipas tij, planin e Vatikanit me klerin katolik për përmbysjen e pushtetit popullor me kryengritje të armatosur:

*“PYETJE: A mund të na thoni në se ekziston një lidhje midis këtyre elementëve dhe atyre të klerit katolik që u arrestuan disa javë më parë në Shkodër e që zhvillonin një aktivitet fashist me anën e organizatës së tyre fashiste «Bashkimi Shqiptar» dhe në se qëllimet e tyre pajtoheshin?*

*PËRGJEGJE: Po, ekziston një lidhje e ngushtë në mes të këtyre grupeve fashiste terroriste dhe atyre të klerit katolik të organizatës «Bashkimi Shqiptar». Kjo lidhje del e qartë nga qëllimet e njëta të tyre në radhë të parë, por ka pasur edhe lidhje organizative në mes të tyre. Elementët e klerit katolik të implikuar në Shkodër, nën maskën e fesë dhe në seminarët e tyre, kishin krijuar qendrën e një organizate fashiste, e cila, në lidhje me elementë joklerikë dhe me kriminelë të luftës, zhvillonte një aktivitet të organizuar kundër pushtetit popullor. Klerikët katolikë dhe katolikët e tyre u zunë në flagrancë me dokumenta në duar dhe në seminarin e tyre u kap material që u shërbente për punën e tyre, e cila konsistonte në përgatitjen e kryengritjes me armë, në rrëzimin e pushtetit të popullit dhe në atentate kundër njerëzve të Frontit.”<sup>11</sup>*

Kriminalizimi i Kishës dhe i klerit katolik kryhej nëpërmjet një procesi të vazhdueshëm propagandistik dhe ishte i ndërthurur me luftën konkrete ndaj meshtarëve, të cilët dhunoheshin dhe pushkatoheshin pa mëshirë. Akuzat ishin ndër më absurdet dhe të kurdisura në mënyrë mjaft djallëzore.

*“Altaret e kishave (katolike, A.N.) ata i kishin shndërruar në depo armësh dhe seminarët fetare e kishat në çerdhe konspiratorësh. Qeveria u doli borxhit, por ata e mbushën kupën; këta zotërinj vazhdonin të organizonin komplotet dhe të gënjenin besimtarët duke shtrembëruar qëllimet e mira të qeverisë sonë. U zbulua i gjithë komploti kriminal i tyre, i cili provoi se ata ishin në shërbim të armikut të popullit shqiptar, Vatikanit dhe në lidhje me reaksionin e brendshëm e të jashtëm. Ata kërkonin t’i bënin varrin popullit tonë, por ranë vetë brenda.”<sup>12</sup>*

10 Hoxha, E. *Vepra*. Vëll. 3, f. 140.

11 Hoxha, E. *Vepra*. Vëll. 3, f. 234.

12 Hoxha, E. *Vepra*. Vëll, 6, f. 284.

Është vërtetuar nga dëshmitarët e asaj kohe dhe nga studimet e botuara pas rënies së komunizmit se historitë e armëve në kisha dhe seminare kanë qenë të organizuara nga Sigurimi i Shtetit me qëllim goditjen e Kishës Katolike. Gjithë këto përshkrime ofenduese ndaj Kishës, shoqëruar me një idiotësi acaruese nuk janë pa strategji. Nëpërmjet një fushate propagandistike në shkallë të gjerë kërkohet që të përballet Kisha Katolike, në mënyrë që dhuna ndaj saj të jetë e justifikuar përballë popullit. Historiani francez A. Besançon e ka përshkruar në mënyrë xixëlluese mënyrën se si funksionon një strategji e tillë:

*“Amështia është sfondi i tablosë së shkatërrimit moral. Është kushti i tij. Sthurja e ndërgjegjes natyrore dhe të pranuar mund të ekzistojë vetëm nëse koncepti për botën dhe lidhja me të vërtetën janë turbulluar parapraakisht.”<sup>13</sup>*

Në fakt, në ligjërimin komunist ka pasur një ndërthurje të përkryer ndërmjet gjuhës së mbushur me idiotësi dhe gënjeshtërs. Në një studim për dukurinë e “njeriut të ri komunist” kam përshkruar se si figurat më të larta të regjimit ishin përfshirë në fushatën e denigrimit të Kishës Katolike:

*“Regjimi, në fakt, qe kërkues dhe i rreptë në veprimin e vet kundër tri feve të përhapura në Shqipëri, por në mënyrë të veçantë qe i pamëshirshëm me Kishën Katolike. Mehmet Shehu, kryeministër gjatë regjimit të Enver Hoxhës deri në vitin 1981, e përkufizoi Kishën Katolike si “një çerdhe reaksioni” dhe jezuitët si “konspiratorë të pabesë.”<sup>14</sup>*

Krahas veprave të diktatorit, një mori e pafund botimesh kundër fesë e veçanërisht kundër asaj katolike botohen para vitit 1967 dhe menjëherë pas tij. Ideologët e partisë komuniste janë mjaft të zellshëm në sulmin ndaj Kishës për t’i dëshmuar besnikëri diktatorit dhe pushtetit komunist. Duke u rikthyer te teza e paraqitur në pjesën e parë mbi sulmin e përzgjedhur ndaj Kishës katolike, është domethënës fakti se vetëm për “veprimtarinë armiqësore të klerit katolik” është botuar një libër i posaçëm.<sup>15</sup>

Studiuesi U. Vehbiu i ka kushtuar dy botime çështjes së fesë nën perspektivën e kriminalizimit të saj. Njëri nga botimet, “Hipnoza dhe feja”, botuar në vitin 1964, jep kontribut të madh në përgatitjen e goditjes së

---

13 Besançon. A. *Novecento, il secolo del male. Nazismo, comunismo, Shoah*. Ideazione Editrice. Roma. 2000, f. 50.

14 Nikolla, A. *Njeriu i ri shqiptar – ndërmjet moralit komunist dhe krizës së tranzicionit*. Onufri. 2012. Tiranë, f. 185.

15 Beqaj, R. *Veprimtaria armiqësore e klerit katolik shqiptar. 1945 – 1971*. Shtypshkronja “8 nëntori”. Tiranë. 1973.

vitit 1967. Autori e shikon fenë si helmuese të mendjeve të njerëzve dhe bën thirrje për luftë ndaj “paragykimeve fetare”. Duke qëndruar në linjën e diktatorit dhe të partisë, ai përpiqet që “sharlatanizmin e fesë “ ta shpjegojë në mënyrë shkencore!

*“Sot tek ne nuk ka më klerikë, por ideologjia fetare akoma ekziston. Kjo ideologji është akoma e fortë sepse ka dhjetëra shekuj që helmon në mënyrë sistematike mendjet e njerëzve.”<sup>16</sup>*

Autori kërkon që, krahas sulmit ndaj ideologjisë fetare, të demaskojë edhe hipokrizinë e klerikëve që, sipas tij, çdo veprim e bëjnë me “paramendim djallëzor”. Është interesant fakti që ka një analogji qartësisht të dallueshme në sulmet ndaj fesë dhe klerikëve në botimet e U. Vehbiut me mënyrën se si diktatori Hoxha sulmon fenë dhe klerikët.

*“Është karakteristik fakti që flet për hipokrizinë e klerikëve; kur sëmuren vetë ata nuk shkojnë tek njëri tjetri për t’u shëruar, por drejtohen tek mjeku, sepse e dinë se puna e tyre është hile dhe gënjeshtë.”<sup>17</sup>*

Në të njëjtën linjë vazhdon ky autor edhe pas ngjarjeve tragjike të 1967-s. Direktiva e Partisë ishte që lufta ndaj fesë duhet të vazhdonte, pasi me mbylljen e objekteve të kultit nuk janë zhdukur nga ndërgjegjja e njerëzve “mbeturinat fetare”! Edhe në botimin e tij të dytë “Sëmundjet psihike dhe feja” ndiqet me përpikëri linja e partisë për luftës ndaj fesë, por del në pah edhe një element interesant: feja katolike paraqitet si më e rrezikshme se të tjerat:

*“... që në shekujt e mesjetës, idetë patologjike të të sëmurëve psihikë, kanë përmbajtje demonologjike («me djallin»), me që në këtë periudhë kohe, feja i kishte helmuar mendjet e njerëzve me mendimin se ekzistojnë kudo «xhindet», që përpiqen të futen në trupat e njerëzve, me qëllim që t’i largojnë ata nga zoti, duke i kthyer në heretikë. Me anën e kësaj teze, feja katolike e kishte më të lehtë të lante hesapet me çdo kundërshtar të saj.”<sup>18</sup>*

U. Vehbiu është i vetëdijshëm për qëllimin e veprave të tij dhe nuk heziton ta përshkruajë këtë qartësisht. Kjo vepër e botuar në vitin 1968 dëshmon për mbështetjen që autori dhe gjithë ideologët e partisë i jepnin revolucionit ideologjik kundër fesë.

16 Vehbiu, U. *Hipnoza dhe feja*. N.SH.Botimeve “Naim Frashëri”. Tiranë. 1964, f. 44.

17 Vehbiu, U. *Hipnoza dhe feja*. N.SH.Botimeve “Naim Frashëri”. Tiranë. 1964, f. 50.

18 Vehbiu, U. *Sëmundjet psihike dhe feja*. Shtypshkronja “Mihal Duri”. Tiranë. 1968, f. 33.

*“Në kuadrin e revolucionit ideologjik që po kryhet në vendin tonë, sot fesë i është dhënë një grusht i rëndë nga i cili s’ka për ta marrë kurrë veten. Por një problem i madh shoqëror e ideologjik ngelet akoma lufta për çrrënjosjen e paragjykimeve fetare.”<sup>19</sup>*

Në këtë botim jepet edhe një kontribut i madh në kriminalizimin e fesë. Pra feja nuk duhet parë vetëm si “mbeturinë fetare ideologjike”, por edhe si frymëzuese e krimeve. Për rrjedhojë, çdo sulm kundër fesë është tashmë i justifikuar jo vetëm moralisht, por edhe penalisht.

*“... paragjykimet fetare kanë pasoja shumë të këqia, mund ta shpien njeriun në krime. Në disa persona qarkullon mendimi se «njeriu mund të lidhet», d.m.th të mos jetë i aftë seksualisht. Në një qytet të vendit tonë ndodhi një krim shumë i shëmtuar. Një i sëmurë psikik ishte impotent nga ana seksuale (nuk bëhej burrë). Njerëzit e shtëpisë çfaqën mendimin se dikush e kishte «lidhur nga ana seksuale». Dyshuan se këtë veprim ja kishte bërë kunata, për disa inate të vjetra. I sëmuri shkoi e u këshillua me hoxhën, i cili ja përforcoi mendimin e «lidhjes së tij nga kunata» dhe i dha një nuskë për ta «zgjidhur» ... I sëmuri, për të shpëtuar nga kjo e keqe, ngrihet një mëngjes herët dhe e qëllon të kunatën me sopatë në kokë.”<sup>20</sup>*

Në këtë mënyrë, direktivat që jep Partia për arrestimet dhe vrasjet e klerikëve janë të justifikuara, pasi potencialisht ata janë kriminelë dhe nxitës të krimeve. Në fakt ishte partia që vendoste se kush dhe me çfarë mase duhej dënuar. Gjykatat kishin për detyrë vetëm të merrnin direktivat e partisë mbi natyrën e krimeve në shoqëri dhe për masën e ndëshkimit duhej t’u referoheshin udhëzimeve të Partisë:

*“Gjykatat në rrethe e në bazë nuk janë të pavarura nga vija e Partisë. Gjykatësin, kur ta shohë të nevojshme, mund ta thërrresë dhe duhet ta thërrresë sekretari i Partisë, apo kryetari i komitetit ekzekutiv i rrethit dhe këta t’i shpjegojnë atij, për shembull, situatën që ka krijuar në Parti dhe në popullin e rrethit një ngjarje e hidhur kriminale që mund të ketë ndodhur dhe cili është opinionioni i Partisë dhe i popullit për këtë ngjarje. Nuk mund të mendohet kurrë që gjykatat tona, njerëzit e popullit dhe të Partisë të mos influencohen nga opinionioni publik, nga opinionioni i Partisë, se ato nuk jetojnë jashtë shoqërisë.”<sup>21</sup>*

---

19 Po aty, f. 41.

20 Po aty, f. 44.

21 Hoxha, E. Vepra. V. 33, f. 296.



## **Ndikimi i revolucionit kulturor kinez në Fjalimin e 6 shkurtit.**

Në këtë klimë të propagandës masive të Partisë, të diktatorit dhe ideologëve të partisë fillon sulmi për mbylljen e objekteve të kultit. Ka mjaft elemente antropologjike që na shtyjnë të mendojmë se Revolucioni Kulturor Kinez ka pasur një ndikim të madh në ngjarjet e vitit 1967.

Një ndër elementet themelore të Revolucionit Kulturor Kinez ka qenë përqendrimi te “vija e masave”. Ndërkohë që në modelin socialist sovjetik mbizotëronte një mënyrë e zhvillimit të socializmit bazuar në idetë e paraqitura nga “inteligjencia” e partisë komuniste, Maoja e përmbysi këtë ide, duke i dhënë përparësi idesë së “vijës së masave”.

*“Para dyzet vitesh, kjo zgjidhje alternative u përfaqësua - prej 1966 deri 1967 e 1969 - nga Revolucioni i Madh kulturor popullor / proletar, një linjë politike që pretendonte për Kinën një zhvillim “modern”, por të bazuar në barazitizmin dhe kontrollin nga poshtë të politikës dhe të ekonomisë - të rinjtë revolucionarë dhe rojet e kuqe e quanin Komuna e re e Parisit - duke refuzuar aplikimin në Kinë të disa recetave dështake, që ishin aplikuar paraprakisht në vende të tjera të realizmit socialist. Vija e Revolucionit kulturor përshkoi dhe çau vijën e Partisë komuniste deri edhe komitetin qendror dhe në qeveri dhe u promovua në maj të 1966 ...”<sup>22</sup>*

Në Kinë përplasia midis përkrahësve të “vijës së masave” dhe përkrahësve të linjës sovjetike të socializmit bëhet shumë e ashpër duke filluar nga mesi i viteve ‘50. Maoja e drejton këtë betejë duke u paraqitur si përkrahës i madh “i vijës së masave” dhe grupet më të mëdha në mbështetje të kësaj linje ishin punëtorët e fabrikave dhe sidomos fshatarësia.

*“... Subjekti kryesor revolucionar i mbështetjes së revolucionit në Kinë ishte fshatarësia (fermerët e vegjël dhe qeradhënësit e tokës bujqësore). Fshatarësia ishte shumë më aktive në revolucionin kulturor sesa klasa punëtore e industrisë.”<sup>23</sup>*

Është e vështirë të gjesh tek veprimtaria politike e E. Hoxhës një linjë të mirëpërcaktuar ideologjike. Kjo jo vetëm për faktin se ka qenë shumë i kufizuar ideologjikisht, një lloj andatari me mendim të rrafshët pa thepa, por edhe për arsye antropologjike që e kanë rrënjën në kulturën dhe historinë shqiptare, ku tribalizmi dhe interesi material kanë pasur një peshë shumë të madhe në aktivitetin politik shqiptar. Kjo arsye na shtyn të mendojmë se E. Hoxha e shikon fenomenin e Revolucionit Kulturor Kinez

22 Di Francesco, T. (a cura di). *L'assalto al cielo. La rivoluzione culturale quarant'anni dopo*. Manifestolibri. Roma 2005, f. 11.

23 Po aty, f. 20.

më shumë si mundësi për përdorimin e dhunës për forcimin e pushtetit dhe përfitime materiale, sesa si një risi politike që e tërheq nga pikëpamja ideologjike. Ai e kopjon atë pa u sforcuar për stërhollime ideologjike.

Studimi interesant mbi Revolucionin Kulturor Kinez i J. Chang dhe J. Halliday *“Mao. The unknown story”* na jep disa dëshmi që ngjallin interes hulumtues mbi qasjen prej përfituesi material të E. Hoxhës ndaj Kinës. Pas prishjes me Bashkimin Sovjetik, Hoxha i shikon kinezët si burim të ardhurash ekonomike.

*“Në janar të vitit 1961, Pekini i jep udhëheqësit shqiptar Enver Hoxha shumën gjigande prej 500 milion rublash ...”<sup>24</sup>*

Në këtë studim shikohet edhe pafytyrësia prej aventurieri e Hoxhës duke shantazhuar Kinën vetëm për t'i marrë ndihma financiare. Pas takimit të Maos me Niksonin, Hoxha e shantazhon Maon se do ta kritikojë në nivel ndërkombëtar, që për Maon ishte shumë problematike, pasi Shqipëria ishte i vetmi aleat në Europë:

*“Mao u bë objekti i shumë kritikave (pas takimit ne Nikson. AN) nga ana e aleatëve të vjetër. Kritika më e ashpër mbërriti nga Shqipëria, së cilës Mao i kishte kushtuar një vëmendje të veçantë ngaqë ishte i vetmi vend i Europës orientale i shkëputur nga orbita sovjetike. Diktatori shqiptar Hoxha i shkruajti Maos një letër prej 19 faqesh në të cilën shprehte zemërimin e tij për atë që ai e përkufizonte si një “marrëveshje muti”. Në fakt, Hoxha me mjaft dinakëri e përdori këtë retorikë për t'i marrë Kinës sasi kolosale ndihmash duke thënë: po behësh shok me armikun, por mund ta blesh heshtjen tonë me më shumë parà. Mao pagoi faturën!”<sup>25</sup>*

Gjithçka që kumtohet në fjalimin e 6 shkurtit të vitit 1967, që shënon edhe vendimmarrjen kryesore për orientimin e Shqipërisë si provincë kineze nën eksperimentimin e revolucionit kulturor, është nën shenjën e dhunës:

*“Revolucionarizim i Partisë do të thotë revolucionarizim i komunistëve. Këta duhet të jenë ushtarë të çeliktë, të qartë politikisht, të guximshëm, të dashur, të hapët, të sinqertë e, kur duhet, edhe të rreptë. Këta duhet të shkatërrojnë çdo gjë të keqe, të mbështetin, të organizojnë dhe të luftojnë në ballë për të renë përparimtare.”<sup>26</sup> (rev kinez! A.N.).*

24 Chang, J. Halliday, J. *Mao. La storia sconosciuta*. TEA. Milano, 2003, f. 524.

25 Po aty, f. 687.

26 Hoxha, E. *Vepra*. V. 35. Fjalimi i 6 shkurtit. 1967, f. 1.

Dhuna është një ndër elementet thelbësore të ideologjisë komuniste dhe E. Hoxha e zbaton këtë aksiomë me zell. E kupton se ajo i garanton pushtetin despotik të pakundërshtueshëm. Çështjen e dhunës e qartëson studiuesi Besançon që kemi përmendur më lart:

*“Formula e Bakunit, e cila përmbledh gjithçka ai kishte kuptuar nga Hegeli, është aksioma kryesore e bolshevizmit: shpirti i shkatërrimit është i barabartë me shpirtin e krijimit!”<sup>27</sup>.*

Dhuna është e drejtuar sidomos ndaj njerëzve që kanë lidhje me fenë, pasi ata janë “mbartës” të ideologjisë së vjetër që nuk përqafojnë të renë. Çdo marrëdhënie e “njeriut të ri të partisë” me njerëzit e fesë është e dënueshme dhe asgjë nuk vlen në veprimtarinë e punëtorit të dalluar, nëse ai shfaq afërsi me “njeriun e fesë”:

*“Si mund të quhet në pozita pararojë ajo organizatë bazë partie e Portit në Durrës dhe si mund të quhet në pozita revolucionare ai punëtor i këtij porti që ditën punon mirë, dallohet, bile edhe lavdërohet, kurse në mbrëmje në shtëpi bën ikona kishe dhe i shet në mëngjes në besimtarë privatë?”<sup>28</sup>*

Hoxha kopjon në mënyrë të përpiktë modelin kinez të revolucionit, sipas të cilit “pushteti buron nga masat dhe u përket atyre”. Për larjen e hesapeve me elementët kritikë në parti ai i krijon një situatë absurde në të cilën askush, përveç atij, të mos ndihet i sigurt, pasi “masat” mund ta ndëshkojnë papritmas secilin burokrat nëse ai shkel vijën e partisë:

*“Ata mund të thonë: - Po ja, nuk na mbledhin sekretarët, nuk na mobilizojnë etj. Mirë, po nuk kemi parë asnjëherë që këta shokë t’ua vënë sekretarëve këmbët në një këpucë për këtë punë dhe, më në fund, t’u ngrenë edhe këmbët, në rast se ata nuk e kryejnë si duhet detyrën.”<sup>29</sup> (Theksimi i A.N.).*

Për sulmin ndaj fesë, Hoxha i referohet një fragmenti thelbësor të motos së Revolucionit Kinez ku paraqitet sulmi ndaj “Katër të Vjetrave”: idetë e vjetra, vlerat e vjetra, zakonet e vjetra, traditat e vjetra.

*“Sulmi ndaj fesë u intensifikua gjatë Revolucionit Kulturor, dhe filloi me eliminimin e “Katër të vjetrave” (idetë e vjetra, vlerat e vjetra, zakonet e vjetra, traditat e vjetra). Besimet tradicionale, të quajtura “bestytni feudale”,*

27 Besançon, A. *Novecento, il secolo del male. Nazismo, comunismo, Shoah*. Ideazione Editrice. Roma. 2000, f. 61.

28 Hoxha, E. Vepra. V. 35. Fjalimi i 6 shkurtit. 1967, f. 1.

29 Hoxha, E. Vepra. V. 35. Fjalimi i 6 shkurtit 1967, f. 1.

*u perfshinë tek “Katërshja e Vjetër” dhe u sulmuan ashpër. Shfaqja e fesë u ndalua krejtësisht. Çdo ritual fetar u nderpre. Shumë tempuj u shkatërruan, disa të tjerë u mbyllën. Imazhet e Budes edhe ata të Muzeut Kombëtar u shkatërruan ose u zhduken. Studimet për historinë e besimeve në Kine u ndaluan, sikur feja të mos kish ekzistuar kurrë (Overmyer, 1986).”<sup>30</sup>*

Termi i preferuar nga Hoxha është “zakonet prapanike”! Çdo arsyetim është nën shenjën e “së resë” që është në luftë me “të vjetrën”. Hapësira ku shquhet më shumë se askund e “vjetra”, “armiçësorja”, “reaksionarja” është ajo fetare, e veçanërisht feja katolike. Në fjalimin e 27 shkurtit 1967 diktatori sulmon fenë katolike si rrezikun më të madh që i kanoset regjimit.

*“Lufta kundër fesë, veçanërisht në vendin tonë, ku nuk ka mundur të zhvillohet në forma filozofike të stërholluara, për arsye të mungesës së një baze klerikësh të zhvilluar e me kulturë, duhet të bëhet me këmbëngulje, sidomos kundër zakoneve, traditave, mënyrës së jetesës, interpretimit të fenomeneve, pse nëpërmjet kësaj rruge klerikët kanë mundur, për shekuj me radhë, të futin helmin e fesë dhe këtë helm ta përziejnë me gëzimet, me hidhërimet, me ngjarjet e përditshme të jetës së njeriut.”<sup>31</sup>*

Në po të njëjtin fjalim, vijon duke theksuar se feja katolike përbën rrezik, pasi ajo e zhvillon “fenë katolike si filozofi”!

*“Klerikët, me përjashtim të katolikëve, aktualisht janë injorantë dhe fenë që predikojnë e mbështetin më shumë në ruajtjen e disiplinave fetare, me anën e një liturgjie arkaike, me psoma dhe duara ose me lutje të mësuara përmendsh, në rastin e hoxhallarëve, pa u kuptuar as brendinë, pa lëre interpretimin e tyre filozofik. [...] Myslimanët as kanë, as mund të kenë dhe as mund të lexojnë ndonjë kuran të vjetër, pse ai është në arabisht. Praktikisht ata «rrojnë» me disa syre të Kuranit, që i mësojnë përmendsh, që nuk i kuptojnë dhe i transmetojnë gojarisht. Ortodoksët s’janë as më të pasur në libra fetarë dhe as më të ngritur. Ata kanë vetëm avantazhin që ungjillin e kanë në shqip. Kurse katolikët, sidomos klerikët e tyre, janë më të pasur në libra, më të ngritur dhe ata, atje ku mundin vazhdojnë ta zhvillojnë fenë katolike si filozofi”<sup>32</sup>.*

Në çdo fragment vërehet se si Hoxha e shndërron figurën e tij një “Mao shqiptar”. Ashtu si Maoja përdor fshatarët për dhunimin e gjithçkaje “të

30 Jiping, Z. *Political Religion: The Case of the Cultural Revolution in China*. In *Sociological Analysis*. March 1991, f. 101.

31 Hoxha, E. Vepra. V. 35. Fjalimi i 27 shkurtit 1967, f. 240.

32 Hoxha, E. Vepra. V. 35. Fjalimi i 27 shkurtit 1967, f. 240.

vjetër” në Kinë duke përdorur “rojat e kuqe fshatare”, në të njëjtën formë Hoxha i jep pushtet të madh masës amorfë kolektive, e cila shndërrohet kështu në një turmë dhunuese që nuk ndalet përpara asgjëje. Ajo masë i bindet vetëm diktatorit:

*“I vetmi gjykim i drejtë dhe i plotë është kontrolli i kolektivit, i cili e verifikon dhe duhet ta verifikojë çështjen. Kjo do të thotë «kontrolli i masës» dhe “politika e masës». Të gjithë, pa përjashtim, duhet t’i nënshtrohen gjykimit të masave mbi punën dhe sjelljet e tyre në shoqëri. Komunistët duhet t’i nënshtrohen një kontrolli të dyfishtë, atij të Partisë dhe atij të masave. Kurrkush nuk mund të thotë se kjo është çështje personale, private, kur ajo është e lidhur me shoqërinë, me normat socialiste dhe të Partisë”<sup>33</sup>.*

Pas sulmit mbi fenë, regjimi “përvetëson” simbolet fetare dhe i përdor ato në funksion të pushtetit sërish duke ndjekur modelin kinez. Janë të shumtë shembujt që e paraqesin diktatorin si një hyjni. Në mjaft krijime popullore që mbështeteshin shumë nga regjimi duke u dhënë statusin e “artit të vërtetë” bejteve të ndryshme, figura e E. Hoxhës paraqitet si zot që do të sjellë drejtësinë ndërkombëtare. Ashtu siç paraqitej Maoja në Kinë, si hyjni, edhe Enveri në Shqipëri është si një zot që bën drejtësi jo vetëm për Shqipërinë, por për mbarë botën:

*“Enver Hoxha e mprehi shpatën; / Edhe një herë o për situatën; / Kjo asht shpata që u rrin tek koka, / Gjithë armiqve o që ka bota” (Popullore. Dedë Ndue Lazri).*

Nga një tjetër poet, Sulejman Mato, paraqitja hyjnore e Enverit është akoma më e qartë:

*“Mbi tokën dibrane binin lule të bardha; / Shkëlqenin nën dëborë, / Rrugët, Pemët e çatitë. / Era lajmin e gëzuar shpërndante fshatrave të dëmtuara; / Po vinte udhëheqësi i madh i partisë. / Vjennjëdiell, i qeshur, / Mbi dëborë, Vet Enveri. / Vjen si një diell mes shtegut të bardhë, / Hyn në shtëpitë e dëmtuara dibrane, / Hyn ... / Dhe dhomat mbushen plot me dritë. / Malësorët dëgjojnë fjalët e udhëheqësit të madh.”*

Ndërkohë në Kinë Maoja konsiderohej hyjni. Këtë e dëshmon dhe studiuesja Z. Jiping me shembullin për lutjet ditore të studentëve në sheshin Tien An Men para se të futeshin në provim apo rrëfimet e tyre para fotos së Maos për mëkatet që kishin bërë:

33 Hoxha, E. Vepra. V. 35. Fjalimi i 6 shkurtit 1967, f. 1.

*“Për ironi të fatit, ndërsa përpiquej të shkatërronte veprimtaritë tradicionale fetare, regjimi komunist kinez, nisi dhe inkurajoi një tjetër fe me në qendër Mao Ce Dunin, kryetar i Partisë Komuniste Kineze dhe udhëheqës i Revolucionit Popullor përgjatë Revolucionit Kulturor. Sikurse sugjerojnë disa studiues perëndimorë, krejt papritmas, Mao filloi të shihej si zot dhe ndiqej shumë nga populli.”<sup>34</sup>*

Një tjetër element simbolik me natyrë fetare në Shqipërinë komuniste vërehet me rastin e ceremonisë së vdekjes së Stalinit. E gjithë masa e njerëzve e pranishme në Sheshin Skënderbej gjunjëzohet në formë adhurimi përpara statujës së Stalinit në mars të vitit 1953, gjatë ceremonisë së zisë kombëtare<sup>35</sup>.

### **Kërkimi në terren. Hajmeli**

Një ndër shkaqet e përzgjedhjes së fshatit Hajmel si rast studimor u bë një letër që gjeta gjatë hulumtimeve të dokumenteve që përmbanin letrat që i dërgoheshin E. Hoxhës nga zona të ndryshme të Shqipërisë në valën e sulmeve kundër Kishave. Në gazetën “Bashkimi” të datës 31 mars 1967, menjëherë pas fjalimit të 6 shkurtit, banorët e Hajmelit i drejtohen E. Hoxhës me këtë letër:

***“DUKE VENË NË JETË MËSIMET E PARTISË, U JAPIM GRUSHTIN E VDEKJES ZAKONEVE PRAPANIKE DHE PARAGJYKIMEVE FETARE***

***Shokut ENVER HOXHA***

***Sekretar i parë i KQ të PPSH***

*I dashtuni shoku Enver*

*Ne, kooperativistët e fshatit Hajmel, të frymëzuar nga vendimet historike të Kongresit të 5-të të PPSH, nga fjalimi Juej i fundit i mbajtur më 6 shkurt, 1967, dhe nga hovi i madh revolucionar që ka shpërthyer në të katër anët e vendit, u mbodhëm sot për të analizuar e diskutuar rreth zakoneve prapanike dhe paragjykimeve fetare.*

*Fjalimi Juej historik ka depërtuar thellë edhe në mendjet e zemrat tona. Në diskutimet tona u shkundëm si asnjëherë tjetër nga konceptet jo të drejta lidhur me zakone prapanike dhe çdo mbeturinë mikroborgjeze në ndërgjegjen tonë. Në fshatin tonë kanë ekzistuar mjaft zakone prapanike të trashigueme në shekuj, të cilat baheshin pengesë për shtimin e pjesëmarrjes në punë dhe damtonin ekonominë kooperativiste dhe të familjeve tona.*

*Këto zakone sado që nuk i kishim për zemër, ishin rranjosë qëllimisht dhe me forcë tek ne nga kleri dhe klasat sunduese, me qëllim që të na mbanin*

34 Jiping, Z. *Political Religion: The Case of the Cultural Revolution in China*. In *Sociological Analysis*. March 1991, f. 101.

35 Burimi: [https://www.youtube.com/watch?v=S\\_zv-A0vZMQ](https://www.youtube.com/watch?v=S_zv-A0vZMQ)

*në injorancë, në ndasi e në grindje me njeni tjetrin, që ta kishin ma të lehtë shfrytëzimin tonë.*

*Ne, të udhëhequn nga organizata e partisë e fshatit tonë, mbasi diskutuem me frymë të naltë revolucionare, ashtu siç na mësoni Ju, shoku Enver, vendosëm:*

- 1. Të heqim nga shtëpitë tona të gjitha ikonat, figurat dhe kryqet nga kulmet e shtëpive dhe dyert.*
- 2. Të mos festojmë ma ditën e emnit dhe ta zavendësojmë ate me festimin e ditëlindjes.*
- 3. Të zavendësojmë të gjitha festat fetare me festat tona kombëtare dhe lokale.*
- 4. Të mos lejojmë fejesën e vajzave kundër dëshirës së tyre dhe në moshë të vogël.*
- 5. Të ndalojmë shit-blemjën e vajzave, matrapazllëqet për pajë si dhe ekspozimin e saj.*
- 6. Të hiqet zakoni i keq i qethjes së vajzave mbas koket, kur ato vishen nuse dhe mbas martesës.*
- 7. Të mos lejojmë përdorimin e duvakut.*
- 8. Të heqim teshat e leshta të martesës si koret, enterit, jelekët e mangët për nuse, kryqat.*
- 9. Të zhduket zakoni i vajtimit të vajzës ditën e daljes nga shtëpia si nuse.*
- 10. Të heqim pasoret për lindje.*
- 11. Të mos lejojmë ngarkesën e grues dhe të heqim zakonin e keq të mos thirrjes së grave me emën.*
- 12. Në raste vdekjesh të mos bahet drekë, por të qitet vetëm kafe e duhan.*
- 13. Të heqim zakonin e keq të kërkesës së lekve në dasma dhe të hiqen lekët e dajës.*

*[...]*

*Ne, kooperativistët e Hajmelit, jemi të bindun, se tue veprue në këtë mënyrë, vemë në jetë mësimet e partisë sonë të lavdishme, shtojmë begatinë e atdheut tonë socialist, u japim grushtin e vdekjes zakoneve prapanike dhe paragjykimeve fetare.*

*Ju sigurojmë, shoku Enver, dhe nëpërmjet Jush Komitetin Qendror dhe Partinë tonë të Punës, se vendimet tona do t'i vemë në jetë.*

*Ju urojmë jetë të gjatë për te mirën dhe begatinë e popullit tonë, Juve, shoku Enver, udhëheqës i yne i dashtun.*

*Nga mbledhja e kooperativistëve  
të fshatit Hajmel rrethi Shkodër*

*«Bashkimi», 31 mars 1967*

Në perspektivën e studimit tim, Hajmeli përbënte një rast mjaft interesant. Unë nuk vij nga ajo zonë dhe ky fakt më garantonte “largësinë” e nevojshme për vëzhgimet e mia antropologjike, pa krijuar asnjë ndrojtje tek personat e përzgjedhur si informues të kërkimit. Prania aty e një mikut tim të afërt dhe puna e tij paraprake për të më siguruar kontaktet e para me personat e përshtatshëm e lehtësoi edhe më shumë vendimmarrjen për të përzgjedhur Hajmelin si rast studimor.

Ndërkohë njohjet që kisha më parë për këtë fshat më shtynin të arsyetoja se kishte mjaft veçori të përputhshme me natyrën e studimit:

- shtrihej në pjesën veriore dhe katolike të Shqipërisë, aty ku persekutimi komunist kishte qenë më i ashpër se kudo tjetër. Kjo do të më lejonte të kisha kontakte të drejtpërdrejta me banorë që e kishin vuajtur personalisht përvojën e vitit 1967. Pra, është një zonë që përmbushte më së miri atë që antropologu Marcel Maus e quan “fakt social i përgjithshëm” ose tërësia e fakteve që ndikojnë e përcaktojnë dukuri të ngjashme, të cilat përfshijnë krejt bashkësinë e njerëzve të një zonë të caktuar. Në rastin e studimit tim persekutimi katolik mund të shihet si “fakt social i përgjithshëm” dhe karakterizues i krejt bashkësisë katolike shqiptare;
- kufijtë e fshatit janë të mirëpërcaktuar dhe banorët e këtij fshati shquhen për një ndjenjë të fortë identiteti, gjë që lehtëson përkufizimin e zonës studimore;
- me ardhjen e Partisë Komuniste në pushtet, Hajmeli u konsiderua si një ndër vatrën e reaksionit, për shkak të antikomunizmit dhe lidhjes së pazgjidhshme me identitetin dhe fenë katolike. Shtypja dhe dhuna e Shtetit komunist arriti kulmin në Hajmel duke e renditur atë ndër fshatrat me përqindjen më të lartë të personave të persekutuar në shkallë vendi. Hajmeli ishte ndër të paktat vende ku u instalua famëkeqi “Reparti i ndjekjes” dhe në planin kulturor “Vatra e kulturës” mori një përparësi të jashtëzakonshme në tentativat e dëshpëruara për indoktrinimin e banorëve të fshatit.

Këto elemente së bashku me nxitjen prej letrës drejtuar E. Hoxhës më çuan drejt vendimit për të hedhur hapat e parë të kërkimit. Kështu, duke filluar prej tetorit të vitit 2016 deri në mars të 2017 kam pasur vizita të shpeshta në Hajmel, kryesisht gjatë fundjavave, kur dhe gatishmëria e informuesve ishte më e lartë. Fillimisht i kërkova mikut tim të më vinte në kontakt ndonjë nga hartuesit e letrës së vitit 1967. Rezultati ishte mbresëlënës, pasi e gjetëm informuesin e parë dhe ishte mjaft i interesuar të fliste rreth atyre ngjarjeve. Pas së pashmangshmes “gotë rakië” me djathë, pyetjes sime rreth historisë së letrës, ai u përgjigj:



*“More bir, se kam lè nuk kam rrejtë kurrkand! U bana rrenacak, për me i pshtue rrenës së madhe të Partisë. Puna e letrës ishte e kurdisun prej nalt. Na kishin thanë që duhet me ba figurë të mirë para Partisë atje nalt e me u tregue revolucionarë. Me të kallxue të drejtën besa, hall i madh ishte ajo punë se unë kishëm fëmijët me mbajtë me bukë e këta të rrasshin mbrendë për kurrnja send”<sup>36</sup>.*

Ai është një burrë rreth të 90-ve, por mjaft i shëndetshëm për moshën e tij. Është besimtar praktikues. Ngaqë punonte në një punë të lakmueshme në kooperativë, e kishin futur menjëherë në “grupin e punës” për hartimin e letrës dhe, prej frikë së humbjes së pozicionit të punës, kishte pranuar të merrte pjesë në shkrimin e saj. Kur kishte pyetur njërin nga nxitësit kryesorë të hartimit të letrës: *“a pënjimend e ke qi njashtu e mendon punën e fesë?”*, ai i ishte përgjigjur: *“edhe ti e mendon njashtu se nuk don me shkue në kazëm, apo jo?”*. Arsyetimi i informatorit përmbledhë në këtë mënyrë: komunistët që kishin në dorë emërimet në pozicionet e “kuadrit” kishin përherë parasysh parimin *“më jep, t’jap”*. Nëse Partia të ka dhënë një punë më të lehtë se punëtor krahu (në kazëm!), atëherë ti duhet të jesh gati ta shpërblesh Partinë për çdo gjë që ajo ka nevojë, përndryshe ajo hakmerret.

Disa nga informatorët pajtohen me njëri-tjetrin në shpjegimin se e gjithë historia e letrës ishte e kurdisur dhe me udhëzim nga lart, nga Tirana. Një pjesë e vogël e aparatçikëve lokalë, për qëllime karriere ishin të gatshëm të ndërmerrnin nisma, edhe nga më absurdet, vetëm për qëllimet e tyre politike. E tillë ishte edhe nisma e mbledhjes së parë për shkrimin e letrës. Por një pjesë e madhe e aparatçikëve ishin njerëz të ndershëm dhe kishin aderuar në partinë komuniste në mirëbesim të plotë e me bindje se janë duke bërë diçka të mirë për bashkësinë e njerëzve. Këtë të fundit, sulmi ndaj kishës i kishte tronditur, por frika i bënte të ishin konformistë. Një informator ka pohuar se në atë takim (për hartimin letrës) të gjithë gënjenin e të gjithë e dinin se secili ishte në dijeni se të gjithë gënjenin.

*“Më ka ba vaki me ndejtë në ndonji sofer a takim me burra ku ndokush prej tyne edhe rrentë ndonji herë, por me marrë pjese në një mbledhje ku të tanë rrejnë e te tanë e dinë se janë tuj rrejtë nuk më kishte ba vaki”<sup>37</sup>.*

Po i njëjti informues më ka rrëfyer mbi bisedat dramatike në familje, pasi kishte një dilemë të madhe ndërmjet një nisme të tillë për të dalë hapur kundër Kishës dhe frikës prej komunistëve që mund ta hiqnin nga puna si magazinier.

---

36 Informuesi i parë.

37 Informuesi i dytë.

*“Vishtirësinë ma të madhe e kam provue me gruen teme që më tha: a thue ke dalë mendsh morë burrë me dalë kundër Kishës? Jo, – i thashë, – nuk kam dalë mendsh, por kam hallin e bukës së gojës për fmijët e mij!”<sup>38</sup>*

Një informues që ka punuar në administratën e kooperativës gjatë komunizmit ka një qasje tjetër ndaj ngjarjeve të 1967-s. Teksa fillojmë bisedën, më pyet: *“A më duket a të kam pa në televizor? Më duket se je i Kishës! Apo jo?”* “Të Kishës jemi të gjithë” – i them. Qasja e tij është interesante, sepse ai sheh gabime të mëdha të Kishës Katolike aso kohe. Sipas tij, nëse Kisha do të kishte ndjekur vetëm çështjen e shërbesave fetare, asgjë nuk do t'i kishte ndodhur.

*“Besa priftat janë marrë me politikë dhe i kanë kërkuë vetë telashet me pushtetin. Tanë priftat që kam njoftë në Hajmel e në zona afër nesh e kanë pasë qef fort politikën. Nuk mund të durojshin pa u përzie. Unë nuk asht se besoj fort, por u kisha thanë priftave që të rrinë në punë të vet e të mos merren me politikë. Unë po të kallzoi se në Kishë të Hajmelit edhe armë ka pasë për më luftue regjimin”<sup>39</sup>.*

Mënyra se si shprehet ky informues për Kishën nuk është dashakeqë, por ai e koncepton politikën si diçka që i përkiste ekskluzivisht Partisë dhe Partia, sipas tij, *“ishte si zjarmi, nuk ishte mirë me ia lujtë drutë, se digjeshe mbrenda”*. Sipas këtij informuesi, edhe ndërhyrjet e sotme politike të Kishës për çështjet e varfërisë apo të gjakmarrjes janë të padrejta, sepse Kisha duhet të merret vetëm me shërbesa fetare dhe asgjë tjetër.

Informuesi i pestë ka një eksperiencë “kineze”. Ka qenë “rojë e kuqe kundër festave fetare”! Po të mos kisha pasur rastin e këtij hulumtimi antropologjik në terren, nuk do ta kisha mësuar që ka pasur roja që ndalonin natën vizitat e fshehta të besimtarëve te të afërmit e tyre!

*“Jam rrefye, po frikë kam se s’ka me më falë Zoti, sepse kam ndaluar, në të dalun të katunit, miq e shokë me u bashkuë me kushrinjtë e vet për Pashkë, për Kshnella e për Sh’Mhill. Na kishte ngarkue organizata bazë që kurkush mos me ardhë për festa fetare, e sidomos me ruejtë shtiqet e katunit mbas orës 12 të natës, se na kishin njoftue se gjinja lëvizte në ato orë të vona”<sup>40</sup>.*

Ai më rrëfen se si organizata bazë e partisë kishte organizuar një grup të rinjsh menjëherë pas mbylljes së Kishave (asokohe ky informues ishte 19 vjeç!), për të ruajtur shtigjet e daljes nga katundi, pasi Partia kishte

38 Informuesi i dytë.

39 Informuesi i katërt.

40 Informuesi i pestë.

informacione se festat fetare vazhdonin të kremtoheshin në fshehtësi! Kjo përvojë zgjati pak kohë, pasi besimtarët këmbëngulnin fort në vizitat e tyre dhe, të paktën në Hajmel, festat fetare janë kremtuar në nivel familjar dhe pa bujë të madhe edhe pas mbylljes së Kishave.

Të gjitha eksperimentet për ta gjunjësuar Hajmelin dështuan në mënyrë spektakolare. Vetë pushteti komunist ishte i vetëdijshëm për këtë dhe tolerimi ndaj festimit masiv të festave fetare gjatë komunizmit ishte konfirmimi më i mirë i një beteje të humbur ende pa filluar. Shumë besimtarë më dëshmojnë se me ardhjen e demokracisë, pikërisht “Vatra e Kulturës”, që ishte ndërtuar “*ex novo*” për të indoktrinuuar hajmelasit, u shndërrua në Kishën e parë të fshatit dhe, për ironi të historisë, në meshën e parë të kremtuar pas 23 vitesh ndërprerjeje të detyruar ishte një ish-komunist që këndoi me një zë melodik rruzaren e shenjtë duke u prirë besimtarëve të shumtë. Kjo tregon se edhe ata pak komunistë që u detyruan të merrnin tesorën e partisë, ishin në shpirt katolikë të përvuajtur që s’kishin asnjë lidhje me idealin e partisë. Është interesante dhe shumë domethënëse të përmendet se në Hajmel, edhe në mbledhjet e organizatës së partisë ndodhte që ndonjë anëtar i saj të betohej me formulën tipike të hajmelasit “pasha Krishtin” në vend të betimit “për ideal të Partisë”!

### **Abstract**

Adapting the Chinese cultural revolution to the Albanian context (1967) affected society deeply. The essay does not purport, however, to explore the whole extent of such social and cultural change. It merely expresses an attempt to study the anthropologic reasons behind such political initiative which run even deeper than the ideas of revolution themselves. Works and speeches by E. Hoxha (and by other demagogues later on) in which the dictator inveighed against all religions – especially against the Catholic church – witness how the revolution had been carefully prepared for much before 1967. The official stance of the dictator on religions legitimised hatred and inaugurated a wave of persecution in the country which did not abate for long.